REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 291, Datë 20.10.2026

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PRODHUESIT EKZISTUES ME PËRPARËSI NGA BURIMET FOTOVOLTAIKE PËR VITIN 2024

Në mbështetje të neneve 10, pika 5, 29, pika 1 dhe 31, pika 2 të ligjit nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.04.2017, *"Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"*; dhe neneve 15 dhe 19 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 3104 prot., datë 16.10.2026 të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve *"Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 202*4",

Konstatoi se:

- ERE me anë të vendimit nr. 36, datë 10.02.2025, vendosi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar prej prodhuesve ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike deri në 2 MW dhe eolike deri në 3 MW për vitin 2024.

- Në vijim të vendimit të sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 998/1 prot., datë 28.02.2025, me lëndë "Njoftim vendimi nr. 36, datë 10.02.2025", njoftoi palët e interesit për fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike deri në 2 MW dhe eolike deri në 3 MW për vitin 2024.

- Gjithashtu, ERE me shkresën nr. 1237 prot., datë 03.03.2025, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me anë të së cilës ka kërkuar informacione, të dhëna dhe dokumente referuese mbi subjektet që kanë marrë miratimin përfundimtar ose kanë nënshkruar kontratë me MIE-n gjatë vitit 2024, mbi të cilat ERE mund të mbështetet për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2024.

- MIE me shkresën nr. 1958/1 prot., datë 11.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 1237/1 prot., datë 12.03.2025 është përgjigjur se MIE për burimet fotovoltaike deri në 2 MW për vitin 2024 ka nënshkruar 2 (dy) kontrata, objekti i së cilave është ndërtimi, shfrytëzimi dhe administrimi i centraleve gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse. Bashkëlidhur kësaj shkrese MIE përcolli gjithashtu një kopje respektive të kontratave të lidhura.

- Procedura për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për vitin 2024 ka përfshirë administrimin, plotësimin dhe vlerësimin në vijimësi të dokumentacionit teknik dhe ekonomik

të nevojshëm për përllogaritjen e LCOE-së. Pas vendimit nr. 36, datë 10.02.2025, ERE ka administruar dokumentacionin e përcjellë nga MIE, të dhënat e proceseve të licencimit dhe informacionin plotësues të shoqërive "DELTA PLAN" sh.p.k. dhe "3 AD ENERGY" sh.p.k.;

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më datë 23.03.2023 ka miratuar ligjin e ri nr. 24/2023 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*.

- Me miratimin e ligjit nr. 24/2023 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*, është shfuqizuar ligji nr. 7/2017. Referuar pikës 5, neni 10, të ligjit nr. 24/2023, përcakton se, për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike dhe eolike caktohet nga ERE në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- Mbështetur në pikën 37, të nenit 3, të ligjit nr. 24/2023, "*Prodhues ekzistues me përparësi*" është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaik deri në 2 MW, eolik deri në 3 MW dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri 15 MW.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.04.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.

- Çmimi i blerjes së energjisë elektrike që miratohet nga ERE është një çmim mesatar i unifikuar; për këtë arsye, secili komponent i LCOE-së trajtohet mbi bazë të mesatarizuar ose me një referencë të përbashkët për kategorinë. CAPEX-i dhe OPEX-i janë përcaktuar nga të dhënat e dokumentuara të projekteve dhe janë mesatarizuar; degradimi është marrë nga karakteristikat teknike të moduleve të parashikuara në projekt dhe është verifikuar me referencat e IEA-s; ndërsa WACC-u, periudha e mbështetjes dhe orët ekuivalente të punës mbështeten në referencat tekniko-ekonomike të VKM nr. 580/2019, e ndryshuar.

- Pas analizimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MIE për shoqëritë të cilat janë Mbajtëse të Miratimit Përfundimtar për ndërtimin e impianteve gjeneruese fotovoltaike deri në 2 MW, si dhe mbështetur në legjislacionin në fuqi, për qëllime të përcaktimit të çmimit të unifikuar të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike për vitin 2024, kosto rezultuese mesatare e investimit është ajo prej 647 mijë Euro/MW, e cila është përllogaritur bazuar në të dhënat e raportuara në planet e përditësuara të biznesit të subjekteve, mbajtëse të miratimit përfundimtar për ndërtimin e veprës.

- Kostot operative vjetore pritet të jenë mesatarisht 62,582 euro/MW/vit. Për llogaritjen e këtij komponenti të LCOE është marrë në konsideratë një periudhë 15-vjeçare, kohë e cila është dhe periudha e marrëveshjes së blerjes së energjisë elektrike. Për vitin 2024, në përllogaritje është përdorur vlera mesatare e intervalit për koston mesatare të ponderuar të kapitalit, pra WACC real prej 9%. Orët e punës mesatare të konsideruara për efekt të llogaritjes së çmimit janë 1,550 orë pune "pik" në vit, ndërsa në LCOE-në e vitit 2024 është përdorur norma lineare e degradimit prej 0.4% në vit pas vitit të parë të operimit.

- Në mbështetje të përcaktimeve të akteve ligjore, VKM nr. 369, datë 26.04.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar

nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", përcakton formulën dhe komponentët përbërës të përllogaritjes së LCOE për teknologjitë fotovoltaike dhe eolike.

- VKM nr. 580, datë 28.08.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2021", i ndryshuar, shpreh vlerësimin më të fundit të kryer nga qeveria shqiptare sa i takon komponentëve të tjerë të LCOE, si WACC, periudha e mbështetjes dhe orët mesatare të punës për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë nga burimet e rinovueshme të energjisë.

- CAPEX-i, OPEX-i dhe degradimi vjetor janë trajtuar mbi bazën e mesatarizimit të kërkuar për çmimin e unifikuar. Për përllogaritjen e LCOE për vitin 2024 është përdorur, si instrument llogaritës, modeli Excel i AGORA-s.

- Nga zbatimi i formulës për llogaritjen e LCOE-së, çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike për vitin 2024 rezulton 94.19 Euro/MWh. ERE, që prej vitit 2017, ka përdorur publikimet e IRENA-s si një nga burimet krahasuese për vlerësimin e kostove dhe parametrave të përdorur në përllogaritjen e LCOE-së për impiantet fotovoltaike dhe eolike.

- Nga analiza e të dhënave të publikuara ndër vite nga IRENA rezulton se kostot kapitale dhe operative të impianteve fotovoltaike ndryshojnë ndërmjet projekteve, tregjeve dhe vendeve. Vlerat mesatare globale të ponderuara të publikuara nga IRENA nuk mund të konsiderohen automatikisht si vlera përfaqësuese për një projekt apo treg të caktuar. Ato shërbejnë si referencë për vlerësimin e tendencave të kostove dhe për krahasimin e arsyeshmërisë së komponentëve të LCOE-së, ndërsa vlerësimi i kostove kapitale dhe operative të projekteve konkrete duhet të mbështetet edhe në të dhënat e dokumentuara të projektit dhe në kushtet e tregut ku ai zhvillohet.

- Nga shqyrtimi i praktikave të vendeve të rajonit rezulton se skemat mbështetëse për impiantet fotovoltaike po kalojnë nga metodat FiT drejt mekanizmave konkurrues. Në Maqedoninë e Veriut, çmimi mesatar i realizuar gjatë vitit 2024 për prodhuesit preferencialë fotovoltaikë ishte 14.38 MKD/kWh (rreth 233 euro/mwh), ndërsa mesatarja historike e skemës feed-in për fotovoltaikët rezulton rreth 217 Euro/MWh.

- Këto vlera përdoren si referenca krahasuese të politikave mbështetëse dhe jo si benchmark i drejtpërdrejtë krahasimor i kostos apo çmimit të blerjes së energjisë nga centralet fotovoltaike me fuqi të instaluar deri në 2 MW. Me VKM nr. 645, datë 27.08.2026, u rishikua PKEK 2020–2030, i cili evidenton orientimin drejt procedurave konkurruese dhe tendencën rënëse të kostove të investimit për teknologjinë fotovoltaike, por nuk përcakton një CAPEX specifik në euro/MW, një normë WACC apo prodhim mesatar për këtë kategori.

- Për procedurën e vitit 2024, inputet e LCOE-së mbështeten në dokumentacionin e projekteve të administruar nga ERE. Pas miratimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga centralet fotovoltaike për vitin 2024, shoqëritë FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. duhet të kryejnë rakordimet dhe kompensimet përkatëse financiare për shoqërinë "3 AD ENERGY" sh.p.k., mbështetur në çmimin e blerjes së energjisë elektrike për këta prodhues për vitin 2024, të miratuar nga ERE.

- Në përfundim, përcaktimi i çmimit për vitin 2024 kryhet në zbatim të metodologjisë së miratuar me VKM nr. 369/2017, e cila vijon të zbatohet në mbështetje të nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, deri në miratimin e aktit nënligjor që e zëvendëson atë.

Për gjithë sa me sipër, bordit ERE-s,

VENDOSI

1. Miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW, prej 94.19 Euro/MWh, për vitin 2024.

2. FTL sh.a., të kryejë rakordimin dhe kompensimin e pagesave për energjinë e blerë nga subjektet të cilat afektohen nga ky vendim, nga data e fillimit të prodhimit deri në hyrjen në fuqi të tij, në zbatim të çmimit të miratuar në pikën 1 te këtij vendimi.

3. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI